



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 14766 Prot

Shkodër, me 16.10. 2023

**FTESË**

**ZNJ. ANA VERUSHI**

**KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK KORÇË**

E nderuara znj.Verushi,

Me porosi të Kryetarit të Këshillit Bashkiak Shkodër z. Oltion Luli, kam nderin dhe kënaqësinë që në kuadër të forcimit dhe konsolidimit të mëtejshëm të bashkëpunimit ndërmjet dy bashkive tona, t'ju ftoj në një takim në Shkodër, me qëllim shkëmbimin e eksperiencave ndërmjet dy institucioneve tona, si organe direkte të përfaqësimit të komuniteteve tona.

Në këtë kontekst, do të çmonim së tepërmi shkëmbimin e njohurive dhe praktikave të orgnizimit të dëgjesave dhe konsultimit me publikun; praktikave të identifikimit të prioriteteve për investime dhe zhvillim të dala nga dëgjesat publike; praktikave të ndërtimit të marrëdhënieve të Këshillit me median dhe publikun; praktikat e gërshetimit të punës së Këshillit me strukturat komunitare në zonat urbane dhe rurale; praktikave të gjithëpërfshirjes dhe punës/përfaqësimit të grupeve të marginalizuara në radhët dhe punën e Këshillit e të tjera iniciativa të ngjashme të dala nga komuniteti dhe përfaqësuesit e tij.

Është kënaqësia jonë t'ju kemi të pranishëm Ju sëbashku me të gjithë anëtarët e Këshillit Bashkiak Korçë, sipas mundësive dhe angazhimeve tuaja, në muajin Nëntor 2023, me qëllim shkëmbimin e këtyre praktikave nga dy palët dhe nxjerrjen e mësimëve se çfarë mund të bëjmë akoma më mirë për komunitetet që ne përfaqësojmë.

*Duke ju falenderuar,*

**Denis LIESHA**  
SEKRETARIA  
BASHKIAK SHKODËR  
SEKRETAR